

Mjetet ndërkombëtare

Ka mjete ndërkombëtare që japin një pamje, në brendësi të të cilit kombet mund të përballojnë problemin e trajtimit përtej kufirit në dëm të grave dhe fëmijëve. Këto dispozita gjenden veçanërisht në Konventat që ekzistojnë. Nëse verifikohen dhe nënshkruhen, këto Konventa janë mjete themelore në nivel juridik. Ndër të tjera, ekzistojnë Deklaratat dhe Programi i Veprimit të Konferencave të mëdha Botërore të Kombeve të Bashkuara, që i ftojnë qeveritë, organizatat qeveritare, ato joqeveritare dhe organizmat e tjerë të interesuar që të ndërveprojnë në mënyrë që të pushojnë dhe parandalojnë këto krime. Dokumentet që i përkasin kësaj kategorie të fundit nuk bëjnë pjesë në nivelin juridik, por ushtrojnë një ndikim politik dhe etik, kështu që mund të përdoren në nivel vendor, kombëtar dhe krahinor.

A. DEKLARATA E PËRGJITHSHME E TË DREJTAVE NJERËZORE - 1948

E miratuar dhe shpallur me vendimin 217 A (III) të Asamblesë së Përgjithshme të 10 dhjetorit 1948. Nenet e aplikuara në këtë problem të trafikimit të grave dhe fëmijëve janë:

Neni 4

Asnjë individ nuk mund të mbahet në gjendje skllavërimi ose shërbimi; skllavërimi dhe trafikimi i skllavëve ndalohen në çfarëdo lloji që mund të paraqiten.

Neni 5

Asnjë individ nuk mund t'i nënshtrohet torturave ose trajtimeve dhe dënimeve të ashpra, jonjerëzore ose poshtëruese.

B. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Zhdukjen e Trafikimit të Njerëzve dhe Shfrytëzimit të Prostitutimit, 1949

(Hyrja në fuqi: 31 korrik 1951)

Konventa forcon marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të marra më parë mbi problemin e trafikimit që nga viti 1904. Objektivi kryesor i Konventës është që të marrë masat paraprake efektive për të luftuar çdo formë të trafikimit të grave dhe shfrytëzimit të prostitucionit. Për herë të parë në një dokument ndërkombëtar, Konventa deklaron se prostitucioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore nuk përputhen me dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe venë në rrezik mirëqenien e individit, të familjes dhe të bashkësisë.



2. Konventa për eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër grave (CEDAW 1979)

(Hyrja në fuqi: 3 shtator 1981)
Dispozita është si më poshtë:

Neni 6

Shtetet duhet të marrin çdo masë të përshtatshme, duke përfshirë dispozitat legjislative, për të shtypur të gjitha format e trafikimit të grave dhe shfrytëzimin e prostitucionit.



3. Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës (CRC) 1989

(Hyrja në fuqi: 2 shtator 1990)

Nenet më të rëndësishme të Konventës përsa i përket trafikimit të fëmijëve, dhe sidomos asaj të vajzave të vogla për qëllime shfrytëzimi janë:

Neni 34

Shtetet angazhohen për të mbrojtur fëmijën kundër çdo forme shfrytëzimi seksual dhe dhune seksuale. Për këtë qëllim, Shtetet marrin çdo masë të përshtatshme në nivel kombëtar, dyanësh dhe shumëanësh për të ndaluar:

- (a) që disa fëmijë të ngacmohen ose të detyrohen që t'i kushtohen një aktiviteti seksual joligjor;
- (b) që disa fëmijë të jenë të shfrytëzuar për qëllime prostitucioni ose për praktika seksuale joligjore;
- (c) që disa fëmijë të shfrytëzohen për qëllime të prodhimit të spektakleve ose materialeve me karakter pornografik.

Neni 35

Shtetet adoptojnë çdo masë paraprake në nivel kombëtar, të dyanëshme ose shumëanëshme për të ndaluar rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çdo lloj forme.

Neni 39

Shtetet adoptojnë çdo masë paraprake për të lehtësuar rikuperimin fizik dhe psikologjik social të çdo fëmije viktimë të çdo forme neglizhence, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo lloj forme dënimi ose trajtimi të egër, jonjerëzor ose poshtëruës, ose të një konflikti të luftës. Një rikuperim i tillë dhe rifutje në shoqëri duhet të zhvillohet në kushte të filla që të favorizojnë shëndetin, respektin e vetë personit dhe dinjitetin e fëmijës.



4. Konventa ILO

Konventat e mëposhtme në lëndën e emigracionit vendosin disa parësi shumë të dobishme në mjedisin e trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual dhe për probleme të tjera të lidhura me këtë fenomen:

- C97 Konventa mbi emigracionin për punën (e rishikuar), 1949 (Hyrja në fuqi më 22/01/1952)
- C143 Konventa mbi Punëtorët Migrues (Dispozitat Plotësuese), 1975 (Hyrja në fuqi më 09/12/1978)
- C182 Konventa mbi Format e Këqija të Punës së të Miturve, 1999: konventa lidhur me ndalimin e formave të këqija të punës së të miturve dhe veprimit të menjëhershëm për eliminimin (Adoptuar më 17/10/1999 por nuk ka hyrë në fuqi) Shprehja "Format e këqija të punës së të miturve" i referohet ngushtë trafikimit të fëmijëve për qëllime prostitucioni dhe pornografie. Neni vazhdon kështu:

Neni 3

Për qëllimet e kësaj Konvente, shprehja "format më të këqija të punës së të miturve" përfshin:

- a) të gjitha format e skllavërisë ose praktikat analoge ndaj skllavërisë, si për shembull shitja ose trafikimi i të miturve, robëria për borxhet dhe skllavëria, puna e detyruar, duke përfshirë futjen me detyrim të të miturve në punë në konfliktet e armatosura;
- b) angazhimin, marrjen me pagesë ose ofertat e të miturve për qëllime prostitucioni, prodhime materiale pornografike ose spektaklesh pornografike.

5. Protokollin për Parandalimin, Eliminimin dhe Dënimin e Trafikut në dëm të Qenieve Njerëzore, në veçanti të Grave dhe Fëmijëve, si shtesë e Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit Transkombëtar të Organizuar, Vjenë 2000 99

(Adoptuar më 02/11/2000 por nuk ka hyrë akoma në fuqi)

Protokollin ofron një përcaktim që përkon me trafikimin e qenieve njerëzore dhe jep kështu një platformë të përbashkët në nivel legjislativ dhe strategjik për të luftuar këtë krim që shtohet shumë shpejt, sidomos në dëm të grave dhe fëmijëve. Objektivat e Protokollit janë si më poshtë:

Neni 2

Objektivat e këtij Protokollin janë:

- (a) Parandalimi dhe luftimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke i kushtuar vëmendje grave dhe fëmijëve.
- (b) Mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të trafikimit, në respektin e plotë të të drejtave njerëzore.
- (c) Nxitja dhe kooperimi i Shteteve për të arritur këto objektiva.

C. DEKLARATA DHE PROGRAMI I VEPRIMIT TË KONFERENCAVE NDËRKOMBËTARE

1. Konferenca Botërore mbi të drejtat njerëzore, Vjenë 1993

Artikujt më të rëndësishëm në pjesën e parë të Deklaratës dhe Programit të Veprimit janë:

Neni 18 (#2)

Dhuna në përgjithësi dhe të gjitha format e ngacmimit dhe shfrytëzimit seksual, duke përfshirë edhe ato që rrjedhin nga paragjykimet kulturore dhe nga trafiket ndërkombëtare, nuk përputhen me dinjitetin dhe vlerën e personit njerëzor dhe duhet të eliminohen. Ky objektivi mund të arrihet nëpërmjet mjeteve legjislative dhe nëpërmjet një veprimi kombëtar dhe një kooperimi ndërkombëtar në fushat si zhvillimi ekonomik dhe social, edukimi, mbrojtja e amësisë dhe e shëndetit, shërbimet sociale.

Neni 21

Konferenca Botërore mbi të Drejtat Njerëzore duke u gëzuar për ratifikimin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijërisë nga ana e një numri të madh të Shteteve dhe, duke nënvizuar pranimin e të drejtave njerëzore të fëmijëve të përmbledhur në Deklarimin Botëror mbi Mbijetesën, Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve dhe në Planin e Veprimit të Takimit Botëror mbi Fëmijërinë, nxit ratifikimin e gjithmbarshëm të Konventës brenda 1995 dhe mbi veprimin efektiv nga ana e Shteteve nëpërmjet adoptimit të të gjitha masave legjislative, administrative, etj. të nevojshme dhe destinacionin e burimeve të mëdha të gatshme. Në të gjitha masat paraprake të marra përpara i përket fëmijëve, vëmendja më e madhe duhet t'i përkushtohet jo diskriminimit dhe interesit parësor të fëmijëve, opinionet e të cilëve duhet të mbahen parasysh. Mekanizmat dhe programet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të forcohen për mbrojtjen dhe ruajtjen e fëmijëve, në veçanti: të fëmijëve vajza, të fëmijëve të braktisur, të fëmijëve të rrugës, të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe seksualisht (edhe nëpërmjet pornografisë fëmijërore, prostitucionit, shitjes së organeve), e fëmijëve viktimë të sëmundjeve si AIDS, e fëmijëve të refugjatëve, e fëmijëve në burg, e fëmijëve të përfshirë në konfliktet e armatosura, dhe të fëmijëve viktimë të urisë dhe të thatësisë ose urgjencave të tjera.

Solidariteti dhe kooperimi ndërkombëtar duhet të nxitet për të mbështetur veprimin e plotë të Konventës, dhe të drejtat e fëmijëve duhet të jenë parësore në sistemin e Kombeve të Bashkuara për të drejtat njerëzore.

Në pjesën e dytë të dokumentit dhe në seksionin B mbi "Barazinë, dinjitetin dhe tolerancën", mes paragrafëve mbi "Kushtin barazues dhe të drejtave njerëzore të grave", ka një artikull sipas të cilit:

Neni 38

Në veçanti, Konferenca Botërore mbi të drejtat njerëzore, nënvizon rëndësinë e angazhimit të kthyer ndaj eliminimit të dhunës kundër grave, në jetën publike ose private; ndaj eliminimit të çdo lloji forme ngacmimi seksual, shfrytëzimit dhe trafikimit të grave; ndaj eliminimit të paragjykit të llojit në administrimin e drejtësisë; ndaj çrënjësjes të çdo lloji konflikti që mund të dalin mes të drejtave të grave dhe efekteve dëmtoese të disa praktikave tradicionale ose të zakonshme, paragjykimet kulturore ose ekstremet fetare. Konferenca Botërore mbi të drejtat njerëzore fton Asambleenë e Përgjithshme për të miratuar deklaratën e përpunuar përpara i përket dhunës kundër grave, dhe nxit Shtetet për të luftuar dhunën kundër grave në përputhje me dispozitat e saj. Dhunimi i të drejtave njerëzore të grave në situatat e konfliktit të armatosur përbën një dhunim të parimeve kryesore të të drejtave njerëzore ndërkombëtare dhe të ligjit njerëzor. Të gjitha dhunimet e këtij lloji, duke përfshirë në veçanti vrasjen, përdhunimin në mënyrë sistematike, skllavërinë seksuale dhe shtatzëninë e detyruar, kërkojnë një reagim veçanërisht efikas.

Ndjek një nen tjetër në pjesën e rezervuar ndaj të "drejtave të fëmijëve":

Neni 48

Konferenca Botërore mbi të Drejtat Njerëzore nxit të gjitha Shtetet për të përballuar, me mbështetjen e kooperimit ndërkombëtar, problemin e fëmijëve që gjenden në situata veçanërisht të vështira. Shfrytëzimi dhe abuzimi i fëmijëve duhet të luftohen në mënyrë aktive, duke përballur shkaqet parësore. Kërkohen masa efektive kundër vrasjes së fëmijëve, kundër punës së të miturve dëmtuese, kundër shitjes së fëmijëve dhe organeve, kundër prostitucionit të fëmijëve, pornografisë që përdor fëmijët dhe format e tjera të abuzimeve seksuale.



2. Konferenca ndërkombëtare mbi popullimin dhe zhvillimin, Kajro 1994.

Kapitulli i katërt i dokumentit i përket "Barazisë së gjinisë, paanësisë së pushtetit nga ana e grave". Në dy Seksionet gjenden nenet që i kushtojnë vëmendje në veçanti dhunës kundër grave, me referimin specifik ndaj trafikut të grave:

Seksioni A: Kushti dhe fitimi i pushtetit nga ana e grave

Neni 4.9.

Kombet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar çdo lloj forme shfrytëzimi, abuzimi, ngacmimi dhe dhune në dëm të grave, adoleshentëve dhe fëmijëve. Kjo është e mundur me një veprim parandalues dhe me rehabilitimin e viktimave. Kombet duhet të ndalin praktikën poshtëruese si trafikimin e grave, adoleshentëve dhe fëmijëve dhe shfrytëzimin nëpërmjet prostituimit, dhe duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë kujdesit të të drejtave dhe sigurisë së atyre që pësojnë këto krime ose që gjenden në kushte shfrytëzimi, si të emigruarat, të ashtuquajturat në shërbimet shtëpiake ose studentet. Për këtë gjë duhet të krijohen mbrojtje ndërkombëtare dhe mekanizma kooperimi për të garantuar aplikimin e këtyre masave paraprake.

Seksioni B: Vajza e vogël

Neni 4.2.3.

Qeveritë nxiten që të marrin të gjitha masat paraprake të nevojshme për të parandaluar vrasjen e fëmijëve të vegjël, seleksionimin paralindës të bazuar mbi seksin, trafikimin dhe përdorimin e vajzave të vogla për prostitucionin ose për prodhimin e materialeve pornografike.

Në kapitullin e dhjetë mbi "Migrimin ndërkombëtar", ka një seksion të titulluar "Emigrantët pa dokumente". Mes objektivave të caktuara ka një nen që vendos:

Neni 10.16.

Parandalimin e çdo lloj forme trafikimi të emigrantëve, sidomos ato për qëllime prostitucioni. Dhe më pas, në një nen që ndjek, ka një këshillë që u drejtohet qeverive:

Neni 10.18.

Qeveritë e vendeve të origjinës së viktimave të trafikimit, dhe ato të kombeve që pranojnë këto persona, duhet të adoptojnë sanksione efektive kundër atyre që organizojnë migrimin klandestin, kundër atij që shfrytëzon emigrantët pa dokumente, kundër atyre që janë të përfshirë në çdo lloj trafikimi ndërkombëtar të grave, adoleshentëve dhe fëmijëve. Qeveritë e vendeve të origjinës në të cilat janë lidhur aktivitetet e agjentëve dhe të ndërmjetësve të tjerë për migrimin duhet të venë në rregull ato aktivitete, në mënyrë që të parandalojnë abuzimet, sidomos shfrytëzimin, prostitucionin dhe adoptimin e detyruar.



3. Deklarata e Beijing-ut dhe Platforma e veprimit të Konferencës së Katërt Botërore të Grave, Beijing 1995.

Objektivi i zonës së katërt të interesit "Dhuna kundër grave" i përket në mënyrë specifike trafikut të grave për qëllim prostitucioni, dhe ndiqet nga përcaktimi i parandalimeve që kanë marrë organizma të ndryshme. Objektivi dhe masat që duhen marrë lidhur me këtë janë:

Objektivi strategjik D. 3.

Të eliminohet trafikimi i grave dhe të ndihmohen viktimat e dhunës të lidhura me prostitucionin dhe me trafikimin.

Nismat që duhen marrë përsipër

130. Nga Qeveritë e Vendeve të origjinës, transitivë dhe të vendmbërritjes, nga organizatat krahinore dhe ndërkombëtare, sipas rrethanave:
- (a) Të konsiderohet ratifikimi dhe aplikimi i konventave ndërkombëtare mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe mbi skllavërinë;
 - (b) Të merren masat e duhura për të përballuar shkaqet e thella, duke përfshirë faktorët e jashtëm, që inkurajojnë trafikun e grave dhe fëmijëve për prostitucion, dhe format e tjera të tregtisë së seksit, martesat e detyruara dhe punët e detyruara, me qëllim që të eliminohet;
 - (c) Trafikimi i grave, në veçanti duke parashikuar forcimin e ligjeve në fuqi me qëllim që të ofrohet një mbrojtje e mirë për të drejtat e grave dhe fëmijëve dhe dënimin e fajtorëve nëpërmjet sanksioneve penale dhe civile;
 - (d) Shtimi i kooperimit dhe veprimit e caktuara në marrëveshje mes të gjitha organizmave dhe autoriteteve e propozuara për mbajtjen e ligjshmërisë, me qëllim që të prishen rrjetat kombëtare, krahinore dhe ndërkombëtare të trafikimit;
 - (e) Caktimi i burimeve për të furnizuar programet globale për të ndihmuar në rifutjen në shoqëri viktimat e trafikimit të grave, duke përfshirë edhe formimin profesional, ndihmën ligjore dhe shëndetësore, konfidenciale, dhe të merren masat e nevojshme për të kooperuar me organizatat jo qeveritare, dhe të ofrohet ndihmë shoqërore, mjekësore dhe psikologjike ndaj viktimave të trafikimit;
 - (f) Të zhvillohen programe dhe politika edukuese dhe formuese, dhe të konsiderohet zgjatja e masave legjislative për të ndaluar turizmin seksual të trafikimit, duke mbrojtur në veçanti gratë e reja dhe fëmijët.



4. Parashikimet dhe nismat e nevojshme për të vënë në veprim Deklaratën e Beijing-ut dhe Platformën e Veprimit, New York-ut 2000

Në nenet që i përkasin dhunës kundër grave përmendet trafikimi, ka edhe nene të kushtuara krejtësisht këtij problemi.

Në seksionet e "parandalimeve që duhen marrë në nivel kombëtar nga ana e qeveritarëve", nenet që e nxisin:

Neni 70

- (a) Të merren masat e duhura për të përballuar faktorët themelorë, duke përfshirë ato të jashtëm, që inkurajojnë trafikimin e grave dhe vajzave të vogla për qëllime prostitucioni dhe format e tjera të tregtisë së seksit, martesat e detyruara dhe punët e detyruara me qëllim eliminimin e trafikimit të grave, duke forcuar

edhe legjislaconet në fuqi që të kihet një mbrojtje më të mirë të të drejtave të grave dhe vajzave të vogla dhe të dënohen zbatuesit, si me masa penale ashtu edhe me ato civile;

- (b) Të ideohen, aplikohen dhe forcohen masat efikase për të luftuar dhe eliminuar të gjitha format e trafikimit të grave dhe vajzave të vogla nëpërmjet një strategjie kundër trafikimit që konsiston, përfshirjen, në masa legjislative, fushatat e parandalimit, shkëmbimet e informacioneve, ndihmën dhe mbrojtjen dhe futjen në shoqëri të viktimave dhe përndjekjen ligjore të të gjithë shkelësve të përfshirë, duke përfshirë edhe ndërmjetësit.
- (c) Në zonën e urdhrit juridik dhe në marrëveshje me politikat kombëtare, të merret në konsideratë mundësia për të shmangur që viktimat e trafikimit, në veçanti gratë dhe vajzat e vogla, të përndiqen për hyrjen dhe qëndrimin joligjor, duke mbajtur parasysh se janë viktima shfrytëzimi;
- (d) Të merret në konsideratë mundësia për të krijuar ose forcuar një organizëm kombëtar koordinimi, për shembull, një relator kombëtar ose një organ ndërministror, me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, përfshirë organizatat joqeveritare, për të inkurajuar shkëmbimin e informacioneve dhe për të referuar të dhënat, shkaqet themelore, faktorët dhe tendencat e dhunës kundër grave, në veçanti të trafikimit;
- (e) Të ofrohet një mbrojtje dhe ndihmë grave dhe familjeve të tyre dhe të zhvillohen e forcohen politikat për të mbështetur sigurinë familjare.

Një grup tjetër nenesh gjendet në Seksionin D. "Parandalimet që duhen marrë në nivel kombëtar nga ana e qeverive, organizatave krahinore dhe ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, institutet financiare ndërkombëtare dhe organizmat e tjerë kompetentë".

Neni 97

- (a) Të intensifikohet kooperimi mes Shteteve të origjinës, transite dhe të vendmbërritjes për të ndaluar, shtypur dhe dënuar trafikimin e personave, mbi të gjitha të grave dhe fëmijëve;
- (b) Të mbështeten bisedimet mbi projektin e protokollit për parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, mbi të gjitha të grave dhe fëmijëve, për ta futur në bocën e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
- (c) Nëse është e nevojshme, të ndiqen dhe mbështeten strategjitë kombëtare, krahinore dhe ndërkombëtare për të zvogëluar rrezikun për gratë dhe vajzat e vogla, përfshirë refugjatet dhe të larguarat, dhe punëtorët emigrante, për t'u bërë viktima të trafikimit; të forcohet legjislaconi kombëtar duke e caktuar krimin e trafikimit në të gjitha aspektet e tij dhe duke forcuar dënimet; të adoptohen politika dhe programe sociale dhe ekonomike, si edhe nisma informacioni dhe sensibilizimi, për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave, mbi të gjitha të grave dhe fëmijëve; të përndiqen përgatitësit e trafikimit; të ofrohen masat për të mbështetur, ndihmuar dhe mbrojtur personat që janë pre e trafikimit në vendet e tyre të origjinës dhe në ato të vendmbërritjes; dhe të lehtësohet kthimi dhe të mbështetet futja në vendet e origjinës.



5. Konferenca botërore kundër racizmit, poshtërimin racial, ksenofobisë dhe padurimit: Deklarata dhe Plani Veprues, Durban 2001.

Në Planin e Veprimit, nenet e shumta që i përkasin trafikimit të grave dhe fëmijëve nënvizojnë në mënyrë të veçantë poshtërimin e shumë të ku janë pre gratë që bëjnë pjesë në bashkësi që pësojnë racizmin, poshtërimin racial, ksenofobinë dhe padurimin.

Neni 38

Pranon se viktimat e trafikimit janë pre e racizmit, poshtërimin racial, ksenofobisë dhe padurimit. Shtetet duhet të garantojnë se të gjitha masat e marra kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhe në veçanti të atyre që i përkasin viktimave të këtij trafikimi, të përputhen me parimet ndërkombëtare të njohura në lëndën e mos poshtërimin, përfshirë ndalimin e poshtërimin racial dhe mundësinë për të fituar drejtësinë;

- c) T'i jepet fund mosdënimit dhe të përndiqen përgjegjësit e krimit kundër njerëzimit dhe të krimit të luffës, përfshirë krimet e lidhura me dhunën seksuale, dhe llojet e tjera të dhunës kundër grave dhe vajzave të vogla të bazuara në gjini; të garantohej që edhe personat përgjegjës të këtyre krimeve, që kanë bërë, urdhëruar, nxitur, favorizuar, mbështetur, ndihmuar, ose sepse kanë kontribuar në çfarëdo lloj mënyre në zbatimin e këtyre, të identifikohen, hetohen, përndiqen dhe dënohen;

Pjesa e tretë e Planit të Veprimit mbi "Masat e parandalimit, edukimit dhe mbrojtjes për çrrënjosjen e racizmit, të poshtërimin racial, të ksenofobisë dhe padurimit, në nivel kombëtar, krahinor dhe ndërkombëtar" përmban nenet e mëposhtme:

Neni 63

Nxit sektorin e bizneseve, në veçanti industrinë e turizmit dhe Internet provider, për të zhvilluar normat për të parandaluar trafikun e personave dhe për të mbrojtur viktimat e trafikimit, sidomos ata që janë të detyruar të prostituohen, nga poshtërimi racial dhe i gjinisë, dhe për të nxitur të drejtat, dinjitetin dhe sigurinë e tyre.

Neni 64

Nxit Shtetet për të ideuar, aplikuar dhe forcuar masat efikase në nivel kombëtar, krahinor dhe ndërkombëtar për të parandaluar, luftuar dhe eliminuar çdo formë të trafikimit të grave dhe fëmijëve, sidomos të vajzave të vogla, me strategji kundër trafikimit që përfshijnë masat legislative, fushatat e parandalimit dhe shkëmbimin e informacioneve. Nxit ndër të tjera Shtetet që të ofrojnë burimet e nevojshme për të krijuar programet e plota që mund t'u sigurojnë viktimave asistencën, mbrojtjen, kujdesin, futjen në shoqëri dhe rehabilitimin. Shtetet duhet të garantojnë, fuqizojnë, formimin e agjentëve të policisë, të zyrtarëve për imigrimin dhe të gjithë funksionarët e tjerë që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit.

Nxitjet në nivel kombëtar gjenden në seksionin "Masat legislative, gjyqësore, rregulluese, administrative dhe parashikimet e tjera për të parandaluar dhe mbrojtur nga racizmi, nga poshtërimi racial, nga ksenofobia dhe nga padurimi".

Neni 69

Nxit Shtetet që të përhapin dhe venë në veprim ligjet kundër trafikut të personave, sidomos të grave dhe fëmijëve, kundër hyrjes dhe nxjerrjes joligjore të emigrantëve, duke mbajtur parasysh praktikën që venë në rrezik jetën e qenieve njerëzore ose që të çojnë në shumë lloje skllavërimi dhe shfrytëzimi, si skllavëria për shkak të borxheve, shfrytëzimi seksual, nxit ndër të tjera Shtetet për të krijuar, aty ku nuk ekzistojnë, mekanizmat për të luftuar këto praktika dhe të ofrojnë burimet e nevojshme dhe për të garantuar aplikimin e ligjeve dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave; të forcojnë kooperimin bilateral, krahinor dhe ndërkombëtar, edhe me organizatat joqeveritare që ndihmojnë viktimat, për të luftuar trafikun e personave dhe hyrjen e daljen joligjore të emigrantëve.

Procedimet gjyqësore kundër përgatitësve të akteve raciste

Neni 88

Fton Shtetet të kriminalizojnë të gjitha format e trafikut të personave, sidomos të grave dhe fëmijëve, dhe të dënojnë penalisht trafikuesit dhe ndërmjetësit, përveç se të garantojnë mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit, në respektimin e plotë të të drejtave të tyre njerëzore;

Në pjesën mbi "Edukimin e të drejtave njerëzore për funksionarët dhe profesionistët", neni që i përket trafikimit të grave është si më poshtë:

Neni 139

Nxit Shtetet që të garantojnë, fuqizojnë, formimin e agjentëve të policisë, të funksionarëve për imigrimin dhe për të gjithë funksionarët e tjerë të përfshirë në parandalimin e trafikimit të personave. Formimi duhet të qendëzohet mbi metodat e krijuara për trafikimin, për të përndjekur trafikantët dhe për të mbrojtur viktimat nga trafikantët. Formimi duhet të ketë parasysh trajtimin e të drejtave njerëzore dhe të çështjeve të tjera të lidhura me fëmijërinë dhe gjininë, dhe duhet të nxisin kooperimin me organizatat joqeveritare, me organizatat dhe me realitetet e tjera të shoqërisë civile;

Në pjesën e katërt mbi "Dispozitat e shërimit, revanshet, ndreqjet efikase dhe masat e tjera në nivel kombëtar, krahinor dhe ndërkombëtar", neni nxit zhvillimin e programeve për shoqërinë në çështje dhe bën një listë të zonave duke përfshirë trafikimin e personave, me vëmendje të veçantë ndaj grave dhe fëmijëve.

Neni 158

Pranon se këto padrejtësi historike kanë kontribuar tek varfëria, zhvillimi i ulët, lënia mënjanë, përjashtimi shoqëror, pabarazia ekonomike, paqëndrueshmëria e sigurisë që kap shumë persona të shumë vendeve të botës, sidomos në vendet që janë në zhvillim e sipër, Konferenca pranon nevojën për të përpunuar programet për zhvillimin social dhe ekonomik të këtyre shoqërive dhe Diasporës, në zonat e mëposhtme:

Trafikimi i personave, sidomos i grave dhe i fëmijëve;

Në pjesën e pestë të titulluar "Strategjitë për të fituar barazinë efektive dhe të plotë, duke përfshirë kooperimin dhe forcimin e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave ndërkombëtare për të luftuar racizmin, poshtërimin racial, ksenofobinë dhe padurimin e asaj që pëson", dy nene nxisin eliminimin e shkaqeve parësore të trafikimit dhe adoptimin e masave të tjera për të parandaluar këtë fenomen.

Neni 174

Nxit Shtetet për të ideuar ose forcuar masat efikase, edhe nëpërmjet kooperimit bilateral dhe shumë anësor, për të përballuar shkaqet parësore, si varfërinë, zhvillimin e ulët dhe mungesën e mundësive të barabarta, disa prej të cilave mund të lidhen me praktikat përlënëse të njerëzve, sidomos gratë dhe fëmijët, vulnerabil ndaj trafikimit, dhe që mund t'i japin origjinë racizmit, poshtërimit racial, ksenofobisë dhe padurimit.

Neni 175

Nxit Shtetet që të organizojnë, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, fushatat e sensibilizimit që sqarojnë mundësinë, të drejtat dhe kufizimet ndaj emigrimit, në mënyrë që të gjithë, sidomos gratë, të mund të marrin vendime të vetëdijshme, pa rrezikuar që të bëhen viktimat të trafikimit.

Në seksionin që i përket "Bashkëpunimit krahinor/ndërkombëtar" neni nxit marrëveshjen e konventave për të përballuar problemin e trafikimit:

Neni 186

Nxit Shtetet për të mbyllur marrëveshjet bilaterale, krahinore dhe ndërkombëtare për të përballuar problemin e trafikimit të grave dhe fëmijëve, sidomos të vajzave të vogla, dhe atë të hyrjes dhe daljes joligjore të emigrantëve.

Një seksion tjetër fton Kombet e Bashkuara për të marrë në konsideratë deklaratën e një dhjetëvjeçari kundër trafikimit.

Neni 201

Nxit Asamblenë e përgjithshme për të marrë në konsideratë deklaratën nga ana e Kombeve të Bashkuara të një viti ose të një dhjetëvjeçari kundër trafikimit të personave, sidomos të grave, të rinjve dhe fëmijëve, me qëllim që të mbrojnë dinjitetin e tyre dhe të të drejtave njerëzore.



6. Seksioni Special i Kombeve të Bashkuara mbi fëmijërinë: "Një botë e përshtatshme për fëmijët. Dokumenti mbi përfundimet e Seksionit Special", New York 2002

Seksioni A i dokumentit, që përcakton "Objektivat, strategjitë dhe parandalimet", përmban një pjesë të tretë të rezervuar "Mbrojtjes ndaj abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunës". Ka një grup nenesh që flasin për trafikimin e fëmijëve me qëllim shfrytëzimin e tyre seksualisht.

Mbrojtja ndaj abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunës

Neni 41

Me qindra milionë fëmijë vuajnë ose vdesin për shkak të luftës, dhunës, shfrytëzimit, pakujdesisë dhe çdo forme abuzimi dhe poshtërimi. Në të gjithë botën fëmijët jetojnë në kushte shumë të vështira: që janë invalidë përgjithmonë ose janë plagosur rëndë në konfliktet e armatosura; të zhvendosur në brendësi të vendit ose që çohen jashtë shtetit si refugjatë: viktima të fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, përfshirë edhe rreziqet si rrezatimi nga substancat kimike dëmtoese; si bijtë e punëtorëve migrues dhe të grupeve të tjera që janë në disavantazh shoqëror; si viktima të racizmit, të poshtërimit racial, të ksenofobisë, të padurimit.

Trafikimi, hyrja ose dalja joligjore e emigrantëve, shfrytëzimi fizik dhe seksual dhe rrëmbimi, ashtu si edhe shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, edhe në format më të këqija, janë realiteti i përditshëm për fëmijët dhe krahinat në të gjithë botën; ndër të tjera, dhunimi shtëpiak dhe dhunimi seksual në dëm të grave dhe fëmijëve përbëjnë gjithmonë një problem të rëndë.

Në vende të ndryshme, sanksionet ekonomike kanë pasur një ndikim të fortë mbi popullimin civil, sidomos mbi gratë dhe fëmijët.

Neni 42

Në disa vende, kushtet e fëmijëve janë goditur nga parashikimet njëanësore që nuk janë në përputhje me ligjet ndërkombëtare dhe me Letrën e Kombeve të Bashkuara që pengojnë marrëdhëniet tregtare mes shteteve, ndalojnë realizimin e plotë të zhvillimit ekonomik dhe social dhe ndalojnë mirëqenien e popullsisë së vendeve mbi të cilat kanë efekt me pasojat e veçanta për gratë, adoleshentët dhe fëmijët.

Neni 43

Fëmijët kanë të drejtë që të mbrohen nga çdo formë abuzimi, shfrytëzimi dhe dhune. Shoqëritë duhet të eliminojnë çdo formë dhune kundër fëmijëve. Ndërkaq, vendosim që:

- a) Të mbrojmë fëmijët nga çdo lloj abuzimi, pakujdesie shfrytëzimi dhe dhune;
- b) Të mbrojmë fëmijët nga konfliktet e armatosura dhe të garantojmë zbatimin e ligjit ndërkombëtar njerëzor dhe atë të të drejtave njerëzore;
- c) Të mbrojmë fëmijët nga çdo formë shfrytëzimi seksual, përfshirë pedofilinë; nga trafikimi dhe nga rrëmbimi;
- d) Të merren masa të menjëhershme dhe efikase për të parandaluar, eliminuar format më të këqija të punës së të miturve siç përcaktohet në Konventën e Organizatës së Punës Ndërkombëtare n. 128; të përpunohen dhe të vihen në praktikë strategjitë për eliminimin e punës së të miturve që nuk përputhet në kriteret ndërkombëtare të njohura;
- e) Të përmirësohet situata e miliona fëmijëve që jetojnë në kushte veçanërisht të vështira.

Mes strategjive dhe masave paraprake të propozuara, një seksion i tërë titullohet "Eliminimi i trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve"

Neni 40

Të merren menjëherë masa paraprake, kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'i dhënë fund tregtisë së fëmijëve dhe të organeve të tyre, shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, përfshirë detyrën e fëmijëve për prodhimin e materialeve pornografike, për prostitucion dhe pedofili; të luftohet tregu ekzistues.

Neni 41

Të kryhen vepra sensibilizimi mbi ilegalitetin dhe mbi pasojat e dëmshme të shfrytëzimit seksual, të abuzimit, edhe nëpërmjet Internet-it, dhe të trafikimit të fëmijëve.

Neni 42

Të fitohet mbështetja e sektorit privat, përfshirë atë të media-ve dhe të industrisë së turizmit, për një fushatë sensibilizimi kundër shfrytëzimit seksual dhe trafikimit të fëmijëve.

Neni 43

Të identifikohen dhe përballohen shkaqet dhe aspektet, edhe ato të jashtme, në rrënjë të këtij fenomeni që të çojnë në shfrytëzimin seksual dhe në trafikimin e fëmijëve, dhe të vihen në përdorim strategjitë parandaluese kundër shfrytëzimit seksual dhe të trafikimit të fëmijëve.

Neni 44

Të garantohet siguria, mbrojtja dhe ruajtja e viktimave të trafikimit dhe të shfrytëzimit seksual; të jepet ndihmë dhe shërbime për të lehtësuar rimarrjen e vetes dhe futjen e tyre në shoqëri.

Neni 45

Të merren masa paraprake të përshtatshme, në të gjitha nivelet, për të dënuar dhe ndjekur penalisht, në përputhje me të gjitha mjetet ndërkombëtare të aplikueshme, çdo formë të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual të fëmijëve, përfshirë edhe atë në brendësi të familjes ose për qëllime tregtie, prostitucionin e fëmijëve, pedofilinë, pornografinë e fëmijëve, turizmin seksual me fëmijët, trafikimin, tregtinë e fëmijëve dhe të organeve të tyre, përfshirjen në punë të detyruar të fëmijëve, dhe çdo lloj forme tjetër të shfrytëzimit; të garantohet se sistemi i drejtësisë penale, duke u marrë me fëmijët që janë viktimë të trafikimit, para së gjithash, interesat e tyre.

Neni 46

Të kontrollohet trafikimi i fëmijëve përtej kufijve dhe shkëmbimi i informacioneve mbi këtë fenomen në nivel krahinor dhe ndërkombëtar; të fuqizohet aftësia e ndërhyrjes së funksionarëve të policisë dhe të funksionarëve të kufijve, dhe të përmirësohet formimi i tyre, kështu që të respektojnë dinjitetin e tyre, të drejtat njerëzore dhe liritë themelore të viktimave të trafikimit, sidomos të grave dhe fëmijëve.

Neni 47

Të merren masa paraprake të përshtatshme, edhe duke shtuar bashkëpunimin mes qeverive, organizatave ndërqeveritare, sektorit privat dhe organizatave joqeveritare, për të luftuar përdorimin kriminal të teknologjive të informacionit, përfshirë Internet-in, për qëllime tregtie të fëmijëve dhe të organeve të tyre, të prostitucionit të fëmijëve, të pornografisë së fëmijëve, të turizmit seksual me fëmijët, të pedofilisë dhe të formave të tjera të dhunës dhe abuzimit në dëm të fëmijëve dhe të adoleshentëve.

D. TRUPI NDËRKOMBËTAR I PËRHERSHËM PËR KRIMIN ROMË - STATUTI 1998.

(Hyrja në fuqi: 1 korrik 2002)

Në nenin që i referohet "Krimi kundër njerëzimit", një klauzolë përcakton krimin kundër njerëzimit shfrytëzimin seksual në kontekstin e një konflikti të armatosur:

Neni 7: Krimi kundër njerëzimit

1. Brenda objektivit të këtij Akti, "Krimi kundër njerëzimit " është një nga aktet e mëposhtme, nëse vihet si pjesë e një sulmi shumë të shtrirë ose sistematik dhe të vetëdijshëm, të drejtuar çdo lloj popullsie civile:

(g) Përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar, ose çdo lloj forme tjetër dhune seksuale e rëndë;

Dhe akoma, në nenin 8 që i referohet "Krimeve të luftës", një klauzolë thotë se:

Neni 8: Krimet e luftës

1. Trupi do të ketë juridiksionin përta i përket krimeve të luftës në veçanti nëse kryhen si pjesë e një plani, një politike ose si pjesë e kryerjes në shkallën e madhe të këtyre krimeve.
2. Brenda objektivit të këtij Akti, janë "Krimet e luftës": (xxii) përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, siç përcaktohet në nenin 7, paragrafi 2 (f), sterilizimi i detyruar, ose çdo lloj tjetër forme dhune seksuale që përbën një dhunim të rëndë të Konventës së Gjinevrës.

Pyetje për laboratorin

1. Studioni Konventat e ndryshme dhe Protokollet e ndryshme të Kombeve të Bashkuara në lidhje me trafikimin e grave dhe fëmijëve, në mënyrë që të pyesni funksionarët qeveritarë mbi ratifikimin e këtyre dokumenteve në vendin tuaj.
2. A mund të kontribuoni mbi sensibilizimin mbi të drejtat e grave dhe fëmijëve? A mund të studioni mbi të gjitha Konventën mbi të Drejtat e Fëmijërisë (Crc) dhe t'i përhapni sa më shumë këto përmbajtje?
3. Cilat prej këtyre konventave/këtyre protokolleve janë nënshkruar dhe ratifikuar nga qeveria e shtetit tuaj? Nxisni qeverinë që të nënshkruani dhe ratifikoni këto dokumente, nëse nuk e keni bërë akoma.
4. Nëse qeveria juaj ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat dhe protokollet, çfarë legjislacioni rezulton? Çfarë masash paraprake janë marrë? Deri në çfarë pike janë vënë në zbatim këto masa?
5. Në këtë moment, si mund të ushtroni ju dhe grupi juaj nxitje mbi qeverinë tuaj? Çfarë ju nevojitet për t'i kërkuar qeverisë për të luftuar trafikimin e grave dhe fëmijëve? Cila është mënyra më efikase për të ushtruar shtytje në lidhje me këtë problem?